

FLORENC SPAHO



Datëlindja: 09.06.1984

Vendlindja: Elbasan

Email: Florenc.Spaho@parlament.al

Jetëshkrimi:

Në vitin 2007 është diplomuar si infermier në universitetin “Aleksandër Xhuvani” dhe po në këtë vit ka filluar punë pranë Spitalit Rajonal të Elbasanit. Gjatë të njëjtës kohë ka ndjekur studimet në degën Fizioterapi. Gjatë viteve 2014-2020 ka ndjekur studimet në Universitetin Mjekësor të Tiranës, dega Mjekësi e Përgjithshme.

Z. Spaho ka nisur aktivitetin e tij profesional qe prej vitit 2007 ku fillimisht ka punuar si fizioterapist pranë një klinike private. Si fizioterapist ai ka qenë i angazhuar pranë Federatës Shqiptare të Karatesë (2008-2014) dhe në Federatën Shqiptare të Futbollit (2015-2017). Më pas në periudhën maj 2007-maj 2019, ai ka ushtruar detyrën e infermierit në urgjencën kirurgjikale në Qendrën Spitalore “ Xhaferr Kongoli” në Elbasan.

Prej vitit 2015 është pedagog me kohë të pjesshme në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, në Departamentin e Infermieristikës, në Universitetin “Aleksandër Xhuvani”. Nga janari 2017 ai punon me kohë të pjesshme 2016 pranë Qendrës Shqiptare për Integrimin e Njerëzve me Nevoja të Veçanta. Nga viti 2019 e në vijim ai është deputet i Kuvendit të Shqipërisë.

Prej vitit 2007 dhe deri tani ka kryer specializime në fushën e fizioterapisë, në Shqipëri por edhe jashtë saj.

Në vitet 2014-2017 ai ka qenë anëtar i Bordit të Shoqatës “Albanian Fund in Support of Sick”.